



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 06 Prot.

Tiranë, 23 / 03 / 2021

VENDIM

Nr. 02 datë 23 / 03 / 2021

**PËR MIRATIMIN E FINANCIMIT DHE KONTRAKTIMIT TË “ASISTENCË PËR
NEGOCIIMIN E TERMAVE TË KONTRATËS KONÇENSIONARE TË
AEROPORTIT TË VLORËS”**

Në mbështetje të Neneve 5 dhe 6 të Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, Shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2457/4, datë 19.03.2021, Këshilli Drejtuesi i AAC-së pasi shqyrtoi relacionin “Mbi kërkesën e MIE për kontraktimin e ekspertizës së jashtme për negociatat e kontratës së Aeroportit të Vlorës”, të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv,

VENDOSI:

1. Miratimin e zërit të shpenzimeve “Asistencë për negociimin e termave të kontratës konçensionare të Aeroportit të Vlorës” në Programin Ekonomik të vitit 2021, me fond 960,000 lekë dhe pakësimin e zërit të investimit “Çertifikimi i sistemit të manaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015”, në masën 960,000 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Kryerjen e procedurave të kontraktimit të asistencës sipas legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohet Drejtori Ekzekutiv për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES

Dritan Gjonbalaj

Dritan
Gjonbalaj

Digitally signed by Dritan
Gjonbalaj
Date: 2021.03.23 07:24:47
+02'00'